



**DËSHMIA E HOXHËS
PËR HOXHËN!**



DETYRA E YMETIT



**PËR TË MOS HARRUAR
BREZI I SOTËM...**

Viti XV - Nr. 2 (168),
Shkurt, 2017

Botim i Myftinisë Shkodër

UDHA ISLAME

*E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative*

**“BETOHUNI SE DO TË QËNDRONI
PËR MBROJTJEN E ATDHEUT
DERI NË VDEKJE!”**



NJË HYTBE NË VEND TË URIMIT PËR PAVARËSINË E KOSOVËS

Kushdo që di të lexojë drejtë idealin e dëshmorëve në Kosovë, do të shohë se sot, në masë të madhe, jemi larg synimit dhe ëndrrës së tyre. Ata nuk luftuan, që për ta fituar shtetin, ta mohojnë Zotin!

Ata nuk luftuan, që për ta fituar shkollën, ta mohojnë lirinë e mësimit dhe të besimit! Ata nuk luftuan, që për ta ruajtur kombin, ta mohojnë fenë!

Ruajtja e amanetit ndaj Allahut dhe lëvizja për t'u afruar sa më pranë njëri-tjetrit, do të na bëjë një shoqëri të dobishme, jo vetëm brenda nesh, por edhe në rrafsh më të gjerë ndërkombëtar.



Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

HZ. MUHAMMEDI (A.S), LAJMËTAR I PAQES...

Selamu alejkum”, pra: “Paqja qoftë mbi ju!”, thirrja e tij: “Përhapeni selamin në mes jush, të duheni!” dhe përshëndetja e tyre, ditën kur do të trashëgojnë xhennetet e Zotit të tanësisë, do të jetë: “Selamun alejkum”!

Për këtë, ai Zotni (a.s): “Kalonte pranë fëmijëve dhe u jepte selam!”, që të mësonte filizat e rinj, se jeta e jonë, feja e jonë, përshëndetja e jonë, thirrja e jonë është SELAMI-PAQJA!

Nga këtu, mendoj se ne si muslimanë e kemi keqlexuar hadithin: “Përhapeni selamin, të paqtoheni!”, ose nuk ia kemi dhënë hakun e duhur kësaj ftese për të jetuar në harmoni e vëllazëri të plotë me njëri-tjetrin, por edhe me botën mbarë! E kemi lexuar cungët, teksa dëshmojmë një gjendje paradoksale të botës tonë islame, tama-tamam, siç paralajmëronte Resulull-llahu (a.s): “Shumë, por shkumë, si shkuma e detit!”...

Sepse trupëzimi i Paqes me Zotin, me veten e tjetrin në jetë, nis që nga vetëdija, brumosja dhe edukimi me kulturën e Paqes; në përshëndetje, në komunikim, në nijet, në vepra, në distancim nga paragjykimi, urrejtja, mendimi i keq për tjetrin, në ruajtje nga haramet, në frenim të nervozizmit dhe në ruajtje të ekuilibrave në jetë, që të gjitha këto të marra së bashku, përbëjnë për ne muslimanët: FÉ! Dhe, feja e jonë është e bazuar mbi themele të forta humanizmi, paqeje, mëshire dhe tolerance!

Ndërkohë, Zoti i gjithësisë i ka cilësuar të nënshtruarit ndaj Tij me këtë cilësi: [E robërit e Mëshiruesit janë ata

që ecin në tokë me butësi, e kur atyre u drejtohen injorantët me fjalë, ata thonë: “Paqe!”] - (Furkan: 63).

Të dashurit e mi,

Të gjithë ne si muslimanë, duhet të ndjehemi krenar për fenë tonë, për të Dërguarin tonë, që thoshte: “Jam dërguar mëshirë dhe s’jam dërguar dënim!”, për Librin tonë Kur’anin, ku Zoti i gjithësisë urdhëron: “E ata, të cilët besuan dhe bënë vepra të mira, me urdhrin e Zotit të tyre u vendosën në xhennete, nën pallatet e të cilëve rrjedhin lumenj, ku do të jenë përgjithmonë. Përshëndetja e tyre në të është “Selam” – paqe” - (Ibrahim: 23). (Dhe, pa e jetuar Paqen e mësuar nga Hz. Muhammedi (a.s) në këtë botë, nuk ka shpërblim në jetën e përtejme!).

Njëkohësisht, jemi të ftuar ta lexojmë dhe ta përvetësojmë si duhet historinë tonë të lavdishme shekullore, sikurse e kemi për detyrë t’ia mësojmë fëmijëve tanë, të afërmeve dhe krejt atyre që akoma kanë dilema, (të ndikuar edhe nga keqinformimi, padija e mosleximi), se vetë Islami është Paqe dhe ndërtim, ura komunikimi, siguri dhe besë, hapje ndaj botës dhe tolerancë, moral fisnik dhe ekuilibër dhe, mbi të gjitha, vepra konkrete, para fjalëve dhe pretendimeve!

(Nga referati i mbajtur në Ulqin, më 18 shkurt 2017, në programin fetar me temë: “Muhammedi (a.s), simbol i paqes”, organizuar nga Mexhli si Bashkësisë Islame Ulqin)

DËSHMIA E HOXHËS PËR HOXHËN!

Si sonte, katër vite më parë, një prej njerëzve të afërm të shoqërisë sime të vjetër, më lajmëroi se në Sharika të Emirateve, sapo kishte ndërruar jetë Hoxha.

Dhembje të madhe i shkaktoi zemrës ky lajm! Edhe sot e kësaj dite, mungesa e tij fizike, këshillat, fjalët e urta dhe shumë të matura, butësia, largpamësia dhe dëshirta e mirë e bashkëpunimit deri në unitet të plotë të muslimanëve, dhembja e zemrës për fatet e Shqipërisë së katandisur në gremina, Shkodërloca të nëpërkëmbur e të keqtrajtuar, lutjet për fuqizimin e vetëdijes islame tek populli ynë dhe mbarë ymmeti, më mungojnë pa fund! Sepse Hoxha, ishte i pashembull!

Në telefonatën e fundit, fare pak ditë para 19 shkurtit 2013, zotnia e tij mezi fliste. I ishte rënduar frymëmarrja, që bashkuar me lëndimin shpirtëror për gjendjen e mjerë për Sirinë e shpirtit, jehonte si një lutje e përgjyruar që përhapet në horizontet e fshehta të botës së Dritës...

Sot, iu riktheva monografisë dhe kujtimeve të vjetra. Lexova dhe risolla në kujtesë shumë e shumë. U ndala tek një Dëshmi zemre, që për mua peshon sa krejt dëshmitë e botës në hak të Hoxhës! Dëshmia e Hoxhës për Hoxhën! Dëshmia e të urtit, Shejkh Ahmed Keftaro për të mirin Shejkh Vehbi S. Gavoçi...

Ja sesi i përgjigjej Kryemyftiu i zemrës, kërkesës sime për një mendim rreth Hoxhës...

*“Bismil- Lahirr- Rrahmanirr- Rrahim
Republika Arabe e Sirisë
Kryemyftiu i Republikës*

Thotë All-llahu (xh.sh): “Po All-llahu ia kanë frikën nga robërit e Tij, vetëm dijetarët!” - (Fatir: 28).

Thotë Profeti (a.s): “Dijetarët janë trashëgimtarët e Profetërve!” - (Ahmedi e shumë të tjerë nga Ebu Derdai).

Me të vërtetë se të folurit për një dijetar nga dijetarët e ymmetit është shpalosje e një faqeje të ndritshme e të shkëlqyeshme nga faqet e dijes, besimit dhe punës së mirë, pasi e vërteta nuk mund të dalë në shesh vetëm se nëpërmjet përfaqësuesve të saj.

Dhe kur flas për Hoxhën e nderuar dhe dijetarin punëtor, vëllanë tim Hirësinë e Tij, Vehbi Sulejman Gavoçi, i cili e mori diturinë fetare nga shkollat

e saj më të mëdha në botë, Ez’heri Sherif, them se ky dijetar edukator është argument në dije e njohuri si dhe shembull në misionin islam dhe në mirësjellje.

Ai është edhe një ndriçues i shkëlqyer për studentët e dijes dhe misionarët, duke përgatitur shpirtat e tyre me edukim dhe pastrim, për të qenë në lidhje të pastër me Zotin e tyre.

Meqenëse ky ymmet është pjellor dhe jo shterpë, gjë për të cilën na sihariqoi edhe Profeti (a.s), duke na thënë: “Me të vërtetë që All-llahu (xh. sh) dërgon në këtë ymmet, në krye të çdo njëqind vjetëve, kë t’i rinovojë atij fenë e tij!” - (Ebu Davudi, Hakimi dhe Bejhaku nga Ebu Hurejra).

Hirësia e Tij Shejkh Gavoçi, është prej burrave të shkollës së reformës konform besimit të Ehli Synneti vel-Xhemaas, prej të parëve tanë të ndershëm, e mbron të vërtetën, punon për t’u realizuar e vërteta, punon në rrugën e vërtetë dhe shpreson tek shpërblimi i All-llahut, Të Vërtetit.

Për këtë, ai ka pasur një ndikim shumë të mirë te studentët e dijes së ndershme, të cilët mbajnë për të, në zemrat e tyre, dashurinë e nderimin, për të mirat që u jep, materialisht dhe moralisht, duke dhënë në këtë mënyrë imazhin e shembullit të lartë e të mirë, për të gjithë ata që e duan dhe bashkëpunojnë me të, sepse dijetari punëtor është shembull në këtë kohë që fjalët janë shtuar dhe punët janë pakësuar.

Prej këtu them se prej virtyteve të Hirësisë së Tij, Shejkh Vehbi Gavoçi është edhe largimi nga fanatizmi, pasi ai ka jetuar në shoqëri të ndryshme islame në shumë prej vendeve, në të cilat ka punuar në mësimin e fesë dhe Thirrjen Islame.

Prandaj është prej besnikërisë dhe nderimit që studentët e Hoxhës dhe nxënësit e tij, të shkruajnë për historinë e jetës së tij, përfshirë këtu edhe pikënisjet shkencore, qëndrimet propagandistike dhe stacionet e edukimit.

Kësaj pune, për të shkruar për mësuesin dhe hoxhën e tij Shejkh Vehbi Gavoçin, i parapriu djali im i zemrës Shejkh Muhamed Sytari, i cili është prej studentëve të Universitetit tonë islam

dhe i diplomuar në Fakultetin e Thirrjes Islame, në Damask dhe i cili mbart në vete cilësi të mirësisë dhe besnikërisë, dijes, njohurisë dhe urtësisë, gjë që e bëri të shkruajë këto faqe të ndritshme, për një dijetar nga dijetarët e Islamit, Hirësinë e Tij, Vehbi S. Gavoçi. Për të qenë pishtar ndriçues dhe shkëndijë shkëlqyese në rrugën e misionarëve dhe udhëzuesve drejt qëllimeve fisnike dhe synimeve të mëdha: Gjetjen e njeriut musliman, i cili është bërthama e parë e familjes muslimane, shoqërisë islame, shoqëri e besimit dhe moralit, shoqëri e vëllazërisë besimore të sinqertë, shoqëri e mëshirës dhe bamirësisë, shoqëri e dashamirësisë dhe mirënjohjes, për të qenë pasardhësit vazhdim i paraardhësve të ndershëm, në qëllim, fjalë e punë.

Pasi vetëm kështu mund të vazhdojë kjo thirrje islame, të cilën nuk ka forcë në botë që ta ndalojë apo të ndikojë në të, pasi burimi i saj është i fortë dhe degët e saj janë të ruajtura në qiell, me mburojën e All-llahut (xh.sh): “Ne me madhërinë Tonë e shpallëm Kur’anin dhe Ne gjithsesi jemi mbrojtës të tij” - (El- Hixhr: 9).

I lutem All-llahut (xh.sh) që ta ruajë Shejkh Vehbi Gavoçin, të lumtur me shëndet dhe begati dhe ta përhapë dobinë e tij për Islamit dhe t’i shpërblejë studentët e tij për këtë punë fisnike.

“Dhe thuaj: “Veproni, All-llahu do ta shohë veprën tuaj, edhe i dërguari i Tij e besimtarët” - (Et-Teube: 105).


Vel hamdu lil-lahi rabbil-alemin

Shejkh Ahmed Keftaro

*Myfti i Përgjithshëm i Rep. Arabe Siriane
President i Këshillit të Lartë të Fetvasë*

All-llahu i Madhëruar e pastë në rahmetin e Tij, Hoxhën dhe e bashkoftë me vëllazërit e tij dijetarë, edhe me “hanefitë e mirë”, sikurse e përsëriste shpesh në derset e tij, si dhe me Zotërinë e bijve të Ademit, Pejgamberin tonë të Shtrenjtë, Hz. Muhammedin (a.s), që sa shumë e donte dhe sa shumë na mësoi ta donim...

Imam Muhamed B. Sytari
Shkodër, më 19 shkurt 2017



Shejkh Muhamed El-Gazali

DETYRA E YMETIT

"Kështu ne ju kemi bërë ymet të mesëm për të qenë dëshmitarë ndaj njerëzve dhe të jetë i Dërguari dëshmitar ndaj jush" (El-Bekare: 143)

Duke përkufizuar detyrën e ymetit arab dhe Ligës së tyre thashë: Allahu edukoi Muhammedin (a.s) për të edukuar me të arabët dhe edukoi arabët me Muhammedin për të edukuar me ta mbarë njerëzit. Kështu që ymeti jonë ka një mesazh të qartë, që duhet të punojë me të, të thërrasë drejt tij, të ngrejë lart flamurin dhe të ndjejnë të afërmit dhe të largët për realitetin e tij. Ky është kuptimi i universalizmit të Islamit, prandaj ai nuk është rimëkëmbje arabe, ashtu siç pretendojnë, apo revolucion popullor siç broçkollisin gënjeshtarët.

Ai është mëshira e Allahut për botët dhe udhëzimi i Tij për njerëzit mbarë.

E, nëse arabët janë tkurrur në këtë kohë, janë bërë popuj copa-copa në tokë dhe çdo popull rend pas kafshatës së gojës dhe kujdeset për jetën e tij të veçantë, atëherë kjo është një formë e harresës poshtëruese, në mos jetë fare një kthim i urryer në periudhën e xhahilijetit!

Megjithatë ekzistojnë grupe, (e për këtë Allahut i takon falënderimi), që refuzojnë këtë gjendje dhe dinë se Islami ka një mesazh të përgjithshëm e të përhershëm. Përparësi kanë lidhjen

e Islamit ndaj çdo lidhjeje tjetër dhe qëllimin e tij përpara çdo qëllimi. Ajetet në Kur'an janë të shumta për universalizmin e mesazhit dhe për të qënurit e ymetit tonë dëshmitarja e ymeteve. Ashtu siç është i Dërguari dëshmitar ndaj nesh, domethënë ne jemi kumtues të trashëgimisë së Shpalljes, ashtu si na e ka kumtuar ai neve. Dhe, jemi dëshmitarë ndaj popujve, ashtu siç është i Dërguari dëshmitar ndaj nesh. Allahu i Madhëruar thotë: "Kështu ne ju kemi bërë ymet të mesëm për të qenë dëshmitarë ndaj njerëzve dhe të jetë i Dërguari dëshmitar ndaj jush".

Ndërsa në një ajet tjetër thuhet: "Ai ju quajti myslimanë më përpara, dhe në këtë që të jetë i Dërguari dëshmitar ndaj jush, e të jeni ju dëshmitar ndaj njerëzve. Prandaj, faleni namazin, jepeni zekatin dhe kapuni për Allahun"².

Jam mërziur kur u befasova me një person, që mohonte këto të vërteta dhe hiqte prej shpatullave barrën e Thirrjes së përgjithshme dhe i zinte myslimanët me çështje të veçanta. Pretendonte se dëshmia ndaj njerëzve është në ahiret dhe jo në dynja, e për këtë sillte një hadith, që nuk e kishte kuptuar. I Dërguari i Allahut (a.s) ka thënë: "Në Ditën e Kiametit vjen Pejgamberi dhe me të një person. Vjen Pejgamberi tjetër dhe me të dy persona. Madje më shumë se kaq. Thërritet populli i tij dhe u thuhet atyre: A jua ka kumtuar ky? Ata

thonë: Jo! Atij i thuhet: A ia ke kumtuar popullit tënd? Thotë: Po! I thuhet atij: Kush dëshmon për ty? Dhe ai thotë: Muhammedi dhe ymeti i tij! Thirret Muhammedi dhe ymeti i tij dhe u thuhet atyre: A ia ka kumtuar ky popullit të tij? Ata thonë: Po! Thuhet: Si e dini? Thonë: Neve na ka ardhur Pejgamberi ynë dhe na ka treguar se të Dërguarit e kanë kumtuar! E, kjo është fjala e Allahut: "Kështu ne ju kemi bërë ymet të mesëm për të qenë dëshmitarë ndaj njerëzve...".

Atij që e solli këtë hadith i thashë se, ai ka ardhur me një shtesë të re, përveç asaj ane që flet ajeti se, myslimanët janë ymet i thirrjes së përgjithshme, përfshinë popujt në të pesë kontinentet dhe kjo shtesa është se, ne jemi dëshmitarë ndaj njerëzve në dynja dhe në ahiret së bashku. Kështu që nuk ka përplasje mes ajeteve dhe hadithit, veçse në mendjet e zhurmuesve dhe mendjelehtëve!

Myslimanët, ndërkohë që me ta është Libri i Allahut dhe syneti i të Dërguarit të Tij, kanë kujdestarinë dhe ustallëkun ndaj njerëzve, të cilët mbushin të gjitha anët e botës, e që nuk kanë punë tjetër, veçse të hanë e të shtrihen. Ashtu siç i nxori i Dërguari prej errësirave në dritë, duhet ta bëjnë këtë me njerëzit dhe do të meritojnë ndëshkimin, nëse e lënë këtë detyrë të lartë.

Përktheu nga arabishtja dhe përshtati në shqip:

Lavdrim Hamja

Allahu edukoi Muhammedin (a.s) për të edukuar me të arabët dhe edukoi arabët me Muhammedin për të edukuar me ta mbarë njerëzit. Kështu që ymeti jonë ka një mesazh të qartë, që duhet të punojë me të, të thërrasë drejt tij, të ngrejë lart flamurin dhe të ndjejnë të afërmit dhe të largët për realitetin e tij.



Hfz. Mehas Alia

Imam, "El-Hidaje", St.Gallen - Zvicër

Falënderimi i takon Zotit të botëve, salavatet dhe selamet i takojnë të Dërguarit të Tij, familjes, shokëve dhe gjithë atyre që e pasojnë për të mirë deri në ditën e gjykimit.

"Dhe çdo të mirë që e keni, ajo është prej All-llahut, madje edhe kur ju godet e keqja, ju vetëm te Ai e ngreni zërin (me lutje)". - (En-Nahl: 53)

Të dashur vëllezër e motra, sot është një ditë e veçantë për ne si shqiptarë, pasi sot përkujtojmë 17 shkurtin, i cili shënon nëntë vjetorin e Pavarësisë së Kosovës. Në medime shohim shumë entuziazëm, shprehje gëzimi e krenari, si dhe shumë organizime të tjera të llojllojshme.

Rëndësia e këtij përvjetori është se shqiptarët po i gëzohen një shteti tjetër të pavarur shqiptar, i çliruar pas shumë mundimesh, torturash e dhunimesh nga agresioni dhe thundra e një shteti, i cili për shumë vite e mbajti peng ëndrrën e lirisë së një populli liridashës.

Sot, ne i krenohemi rezistencës sonë, vullnetit dhe besimit tonë se vetëm të organizuar dhe të bashkuar do të mund t'i dalim në krye të gjitha

NJË HYTBE NË VEND TË URIMIT PËR PAVARËSINË E KOSOVËS

"Dhe çdo të mirë që e keni, ajo është prej All-llahut, madje edhe kur ju godet e keqja, ju vetëm te Ai e ngreni zërin (me lutje)". - (En-Nahl: 53)

çështjeve, të cilat ndonjëherë duken të pakapërcyeshme.

I nderuari xhemat, populli që e do lirinë, një ditë ka për ta fituar atë. Kështu është për shkak se gjithmonë ka qenë që dëshira dhe vullneti ta mundin hekurin, grushtin dhe armën.

Sot, vërejmë se aspirata jonë historike, e atyre që sakrifkuan më të mirën e tyre të jetës për të na dhuruar neve një mirëqenie më të sigurt, nuk është në ujdi me zhvillimet aktuale politike, kombëtare e fetare.

Kushdo që di të lexojë drejtë idealin e dëshmorëve në Kosovë, do të shohë se sot, në masë të madhe, jemi larg synimit dhe ëndrrës së tyre. Ata nuk luftuan, që për ta fituar shtetin, ta mohojnë Zotin! Ata nuk luftuan, që për ta fituar shkollën, ta mohojnë lirinë e mësimin dhe të besimit! Ata nuk luftuan, që për ta ruajtur kombin, ta mohojnë fenë!

Të dashur vëllezër e motra, shikoni se sa bukur na ka bashkuar xhamia. Kështu na ka bashkuar gjuha, kultura, kombi e feja. Sado të ndarë që të jemi, nëse nuk e humbim vullnetin dhe dëshirën për t'i qëndruar pranë njëri-tjetrit, ne këtë do ta arrijmë, inshallah. Lutjet, ëndrra dhe sakrifica e shehidëve tanë nuk duhen harruar! Të mos kënaqemi me kaq, por të punojmë shumë për të arritur edhe shumë gjëra të tjera që na presin në prag të së nesërme.

Ne, si brez i ri, që jemi lindur e rritur në mërgim, duhet të mësojmë

se si ruhet e duhet të ruhet vatani dhe feja; se si mbrohet nderi e familja; se si çmohet vëllai e motra, e se si qëndrohet i palëkundur përballë sfidave të reja të kohës! Nëse ne sot nuk ballafaqohemi me armën e hekurit, dijeni që sot, po kërcënohemi nga arma e paditurisë, shfrenimit dhe çoroditjes!

Brezi i ri duhet të mësojë për heroizmin e çiltër të të parëve tanë. Brezi i ri, duhet të di se Adem Jashari ra në beteja si trim i vërtetë, si luftëtar i paepur në rrugën e lirisë së tokës e Atdheut! Ishte trim prej trimash. Ai u vra, ndërkohë që ishte agjërueshëm dhe me abdes! Plumbat e tij nuk dilyn me të shara, por me "bismilah", sepse ai donte që ky shtet të ngrihej me "bismilah", dhe shqiptarët të jetojnë me "bismilah".

Për fund, uroj që në këtë përvjetor, kombi ynë ta ketë kuptuar aspiratën e vërtetë të të parëve tanë dhe se e ardhmja duhet t'i shërbejë pikërisht këtij përkushtimi. Ruajtja e amanetit ndaj Allahut dhe lëvizja për t'u afruar sa më pranë njëri-tjetrit, do të na bëjë një shoqëri të dobishme, jo vetëm brenda nesh, por edhe në rrafsh më të gjerë ndërkombëtar.

E lus Allahun e Plotfuqishëm që vitet në vijim të jenë të bardha, për ne si shqiptarë, për myslimanët mbarë dhe për tërë njerëzimin! Amin!

(Hytbeja e xhumasë, 17.02.2017, Xhamia "El-Hidaje", St. Gallen - Zvicër)

PËR TË MOS HARRUAR BREZI I SOTËM...

Diku në Tiranë, në një aktivitet lokal është përkujtuar sot, në 50 vjetorin e fjalimit më famëkeq në historinë e shtetit shqiptar, propaganda dhe lufta e organizuar e shtetit shqiptar kundër fesë dhe aktivitetit të saj.

(Megjithëse më kishte ardhur një ftesë për të qenë i pranishëm në këtë aktivitet, nuk isha, edhe për shkaqe personale).

Ndërkohë, mjerisht, kjo datë kaloi pa një memorie serioze kombëtare, si nga institucionet shtetërore, (që sot duhet të kërkonin një falje të madhe publike ndaj Besimit dhe besimtarëve, por edhe ndaj krejt popullit shqiptar, për krimet barbare të komunizmit në këtë vend!), ashtu edhe nga institucionet fetare, që gjithësesi, duhet të ishin në avantgardë të këtyre organizimeve.

Gjithësesi, në këtë krahur, ku janë katandisur njerëzia dhe institucionet tona, nuk është për të ardhur habi nga askush dhe nga asgjë!

Iu riktheva arkivit tim, ku gjeta një dosje të madhe me shënime të publikuara ndër vite e dekada, nga propaganda dhe lufta e egër kundër Islamit dhe muslimanëve, besimit dhe besimtarëve në Shkodër dhe mbarë vendin! Sa mjerim i madh! Sa pak reflektohet e sa shumë është harruar!

Për efekt të shënimeve të kësaj dite, po sjell në vëmendjen tuaj disa nga këto gjurmë, (që edhe në momente të ndryshme, i kam përmendur dhe besoj se në vazhdimësi duhen risjellë në kujtesë).

1. Banorët e bllokut nr. 1-2 të lagjes “Kongresi i Përmetit”, në Shkodër, i drejtoreshin diktatorit me një letër të hapur, ku mjerisht (në çdo sens të kësaj fjale), i shkruanin:

“Nën dritën e fjalimit tuej të 6 shkurtit, ju premtojmë se do të përqafojmë dhe do t'i vemë në jetë mësimet e partisë për zhdukjen e të gjitha mbeturinave, do të djegim me zjarr çfaqjet e hueja që pengojnë ecjen tonë përpara dhe do të kalitemi me moralin komunist.

Pak ditë ma parë ne vendosëm njëzani t'i kthejmë dy xhamijat e lagjes nga institucione të errësinës dhe vatra të propagandës së çfrenueme kundër interesave të popullit në qendra për edukimin dhe argëtimin e brezit të ri...

Tue kuptue damin që i sjellin familjes dhe shoqnisë zakonet prapanike dhe bindjet fetare, ne zotohemi:

1) Do të punojmë me të gjitha forcat



si aktivistë të organizatës së frontit për të dërmue çdo gja që pengon, sado pak, ecjen tonë në rrugën e caktueme nga partia jonë e lavdishme.

2) Do të heqim të gjitha ceremonitë e festat fetare që kanë xanë vend deri tashti.

3) Nuk do të presim njeri për festat fetare. ...” – [Letër e hapur e popullit të bllokut nr. 1-2 të lagjes “Kongresi i Përmetit”, Shkodër, me titull: “Do të heqim të gjitha ceremonitë e festat fetare”, në gazetën “Zëri i popullit”, v. 26, nr. 73 (5798), e dielë, 26 mars 1967, fq. 3. (Letra mban datën 19 mars 1967)].

2. Te “Rubrika e mjekut”, në gazetën “Jeta e re”, shkruhej se: “Në vendin tonë rinia dhe mbarë populli, të edukuar nga partia me qartësi politike dhe ideologjike, u çuan në këmbë, po fshijnë nga jeta dhe ndërgjegjia mbeturinat e botës së vjetër dhe rreziku i fesë dhe paragjyqimeve të saj është pakësuar...” – (Dr. Z. Ç., “Për t'i zhgultur me rrënjë, duhen njohur me rrënjë”, në gazetën “Jeta e re”, viti I, nr. 75, e shtunë, 30 dhjetor 1967, fq. 3).

3. Po nga Shkodra, buçiste një zë i kobshëm, që shëmtueshëm, thërriste: “Për vazhdimin e luftës kundër ideologjisë fetare, shumë i vlefshëm do të ishte krijimi i një muzeu ateisto-shkencor në qytetin tonë. Hapja e një muzeu të tillë, për të cilin janë krijuar mundësitë, do t'i vlente jo vetëm qytetit dhe rrethit tonë, por edhe rretheve të tjera”. – (L. F., “Përdorimi i emrave me origjinë fetare është i dëmshëm”, në gazetën “Jeta e re”, viti II, nr. 59 (134), e mërkure, 24 korrik 1968, f. 3).

E, muzeu ateist do të ndërtohej në Shkodër, për ta njollësuar me turp historik Shkodrën e dijes dhe dijetarëve!

Për fat të keq të këtij qyteti, ajo farë e keqe e artikullshkruesit të

lartpërmendur, vazhdon edhe sot e kësaj dite me propaganda islamofobe dhe osmanofobe, që kanë për qëllim thelbin e Islamit dhe muslimanët, simbolet tona dhe trashëgiminë tonë të mrekullueshme!

Këtyre u duhet prerë hovi me të gjitha mënyrat legjitime, sikurse duhet imunizuar rinia e jonë kundrejt helmit dhe vnerit të tyre të vazhdueshëm, që gjithësesi mbetet përherë edhe një kërcënim kombëtar për Shqipërinë tonë dhe vlerat e besimit në të! Kjo frymë e keqe, është përhapur masivisht edhe në Kosovë, prandaj duhet të kemi kujdes të madh!

Sot, më shumë se asnjëherë, ne si muslimanë, por jo vetëm, e kemi për detyrë të kapemi fort pas fesë sonë dhe të drejtat legjitime, si dhe të jemi shumë të vëmendshëm përballë sprovave dhe tendencave për ta njollësuar fenë tonë me çfarë prodhohet ditë pas dite në laboratorët e së keqes, injorancës dhe fanatizmit të verbër!

Fjalët e Hafiz Ali Krajës, duhet të na frymëzojnë edhe sot, kur të ngjashëm me të shkuarit dhe etërit e tyre shpirtërorë, përpiqen të ushtrojnë mjerimin e tyre kundër Islamit dhe muslimanëve, sidomos nëpërmjet politikave të laicizmit selektiv, që janë bërë tashmë të neveritshme tek ne!

“... lus vllaznit musliman të mos gënjejnë me fjalët e bukra t'asaj pjesë pseudo-intelektualsh, pse qellimi i këtyre është me dësuar konvikcionin dogmatik në shpirtin e fetarve, e nuk janë fjalë të bazueme... mbi shkencë e fillosofi” – (Hafis Ali Kraja, “A duhet feja- A e pengon bashkimin kombtar?”, Shkodër, 1934, f. VI).

Imam Muhamed B. Sytari

*Myfti i Zonës Shkodër
Shkodër, më 6 shkurt 2017*

GJURMËT E ISLAMIT PARAOSMAN KOSOVA KISHTE XHAMI QË NË VITIN 1289

“Allahu ekber, Allahu ekber, ...,
Esh-hedu en la ilahe il-lall-lah,
Esh-hedu en la ilahe il-lall-lah ...”.

Kjo thirrje po përhapej në fshatin Mlikë të Gorës në Dragash, ende pa zbarkuar pjesëtarët e ushtrisë osmane këtë javë. Mirëpo, historianët pohojnë se kjo thirrje është dëgjuar në të njëjtin fshat qysh nga kohët e hershme, bile edhe para ardhjes së osmanëve në Ballkan.

Në këtë zonë malore thirrja e xhematit për faljen e namazit është bërë nga xhamia që besohet të jetë ndër faltoret e para të besimit islam në Ballkan. Si e tillë në bazë të fakteve historike të gjetura deri tani supozohet se themelet e saj janë vendosur në bazë të iniciativës së familjeve të ardhura nga Halepi i Sirisë, të cilët me vete kanë bartur edhe traditën shpirtërore, duke e vendosur atë në këto bjeshkë, me ç'rast edhe kanë influencuar banorët lokalë.

Sipas historianëve janë disa elemente që bëjnë të besohet se ky objekt i kultit ka qenë i ndërtuar para ardhjes së osmanlinjëve dhe si i tillë dëshmon se Islami në këtë zonë ka filluar të praktikohet para tyre.

“Mbishkrimi i Xhamisë në fshatin Mlikë flet se në këtë trevë Islami ka qenë prezent që në shekullin XIII, përkatësisht para pushtimit të Prizrenit (1459) dhe të rajonit nga Osmanët”, ka konfirmuar historiani Parim Kosova, njëherësh përgjegjës i kompleksit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Në bazë të të dhënave që ai ka grumbulluar gjatë hulumtimit të Gorës dhe veshjeve të saj tradicionale gjatë shekullit XX, ai ka hasur edhe në veçantitë e kësaj xhamie, ku në bazë të shënimeve besohet se ndërtimi i saj është bërë disa shekuj më parë.

Sipas një vërtetimi të lëshuar nga Ministria e Vakufëve – Drejtoria e përgjithshme e myftinjve dhe të arsimit fetar të qarkut të Halepit të Republikës Arabe të Sirisë, datë 10 tetor 1995, pos të tjerave theksohet: “...që disa anëtarë nga familja Al Aga nga Halepi (Sirisë), kanë filluar të vendosen në këtë fshat prej vitit 1205 deri në vitin 1291, ku edhe e ndërtojnë xhaminë në fshatin Mlikë...Xhamia është pronë e këtyre familjeve të shpërngulura myslimane



“MBISHKRIMI I XHAMISË NË FSHATIN MLIKË FLET SE NË KËTË TREVË ISLAMI KA QENË PREZENT QË NË SHEKULLIN XIII, PÛRKATËSISHT PARA PUSHTIMIT TË PRIZRENIT (1459) DHE TË RAJONIT NGA OSMANËT”, KA KONFIRMUAR HISTORIANI PARIM KOSOVA, NJËHERËSH PËRGJEGJËS I KOMPLEKSIT TË LIDHJES SHQIPTARE TË PRIZRENIT.”

arabe dhe nuk është prej ndërtimeve osmane”, ka sqaruar Kosova.

Një gjë e tillë sipas këtij historiani dëshmohej edhe nga mbishkrimi i gdhendur në gurë, që ndodhet në murin e Xhamisë, i cili thotë “...është rindërtuar në vitin 1822/3 (Hixhri 1238), nga ana e Ahmet Agës dhe xhamia e parë kishte qenë e ndërtuar në vitin 1289 (Hixhri 688)...”. Sipas këtyre dy argumenteve, Parim Kosova ka shpjeguar që mendohet se ky objekt fetar, pas xhamive të Kërmahallës në Gumulxhinë në Bullgari dhe të qytetit Madan (të ndërtuar më 1233) të Bullgarisë Jugore dhe Xhamisë së vjetër në qytetin e Beratit, është prej faltoreve të para Islame në Ballkan.

Të gjitha këto të dhëna shtojnë besimin se Xhamia në Mlikë është ndërtuar 100 vjet para Betejës së Kosovës, përkatësisht 170 vjet para rënies së Prizrenit nën pushtimin osman. Ndërkohë që edhe sot lagja ku ndodhet xhamia quhet Helepovci, derisa qyteti i Halepit në atë kohë ishte në kuadër të Bejlikut të familjes aristokrate Dylkadërogullari.

Megjithatë, kjo pasuri e rrallë e trashëgimisë kulturore e historike, që dëshmon për ecejaket shpirtërore të kësaj treve nuk është arritur të ruhet në formën e saj origjinale. Në shekullin XIX objekti fetar është kapluar rastësisht nga flakët, në të cilën mënyrë janë

shkatërruar gjëra të shumta të vlefshme që ishin bartur brez pas brezi. Sipas Hoxhes së tanishëm të xhamisë “xhamia ishte djegur rastësisht në vitin 1822/3, e atëherë ishin djegur edhe shumë dokumente e libra, si dhe vetë tapia e xhamisë...”, ka spikatur Kosova.

Ndonëse kjo fatkeqësi ka lënë pasojë negative në ruajtjen e objektit që dëshmon për kultivimin e traditës, kulturës e jetës shoqërore të banorëve të kësaj ane, ajo nuk ka mundur t'i shlyej gjurmët e zhvillimeve shpirtërore dhe thellimit të besimit. Ndikimi që kjo xhami ka lënë në praktikimin e fesë islame ka qenë i konsiderueshëm, duke mos harruar në këtë drejtim edhe Kukli Begun e Opojës dhe familjen persiane të Hysen Agë Shtekut të vendosur në Kolesjan të Lumës, të cilët gjatë shekullit XVI patën ndikim të madh në procesin e islamizimit në popullsinë e këtij visi. Ndërkohë xhamitë e tjera që vlenë të përmenden janë ajo e fshatit Kukalan të ndërtuar në vitin 1515, ajo e krahkoshtës në vitin 1528, e Brodit, Leshtanit, etj. Për më shumë, të gjitha fshatrat e Gorës në pjesën e Kosovës sot kanë xhamitë e tyre, të cilat janë aktive dhe mirëmbahen nga ana e besimtarëve.

(www.kohaislame.com)



Gëzim Kopani
Myfti i Pukës

Mejtepi i xhamisë Qerret Pukë është një ndër Mejtepet më të njohura të Myftinisë Pukë. Sipas të dhënave Mejtepi i xhamisë Qerret Pukë ka filluar që në shek. 18-të. Ndërsa banorët arrijnë të shkojnë saktësisht deri në vitin 1892 duke radhitur brezat që kanë marrë mësim në këtë mejtep.

Në fillim mësimet e Mejtepit zhvilloheshin brenda ambienteve të xhamisë së fshatit Qerret. Më vonë u ndërtua përball xhamisë një godinë vetëm për mejtepin. Sipas Elez Tafllakut “Xhamia e fshatit Qerret dhe mejtepi janë ndërtuar në një tokë të dhuruar nga vetë banorët e fshatit Qerret. Xhamia ka pas minare me gurë të gdhendur. Unë kam bërë Mejtep në xhamin e fshatit Qerret. Në kohën time mbaj mend se kemi qenë rreth 30 fëmijë. Përveç mësimi të Kur’anit (duke mësuar sure) kena pas mësuar salavate, tekbire, dua të ndryshme si dhe Mevlud. Në fakt në kohën time kena pas mësuar edhe gjuhën shqipe. Kena pas një hoxhë që quhej Qazim Nushi, i cili ishte shumë i dashur. Na merrte me vete nëpër fshat. Në muajin e Ramazanit shkonim së bashku në Xhamin e Qerretit. U bënë rreth 20 burra. Disa shtëpi të fshatit e thirrnin hoxhën për iftarë. Kishte raste që shkonte për shërbime në xhamin e Kabashit, Kodër Hanit në Pukë etj. Me sa di unë, në xhamin e fshatit Qerret përveç Qazim Nushit kanë pas shërbyer edhe hoxhallarë nga Shkodra dhe Kosova.”¹

Ndërsa Ahmet Dunga² tregon: “... Xhami ma të bukur pas Shkodrës në

1. Elez Tafllaku; nxënës i imam Qazim Nushit, ndihmës myezin i Xhamisë së fshatit Qerret. I pari telegrafist pukjan në rrethin e Pukës.
2. [2] Ahmet Dunga; nxënës i Mejtepit të fshatit Qerret. I datëlindjes 5 janar 1931. Nga viti 1956-1988 ka punuar në zyrat e Postës në qytetin e Pukës. Po ashtu telegrafist.

VLERA E MEJTEPIT TË XHAMISË SË FSHATIT QERRET, PUKË (1892)

“Në Myftininë e Pukës një ndër Mejtepet më të njohura ka qenë ai i fshatit Qerret. Sipas të dhënave të besimtarëve mysliman të fshatit Qerret del se; “Mejtepi i fshatit Qerret është hapur në shekullin e XVIII.” Në këtë Mejtep janë dhënë mësim mbi Kur’anin, ilmihalin, historinë islame madje edhe këndim e lexim në gjuhën shqipe. Me miratim të Myftinisë Pukë Mejtepi i fshatit Qerret shërbeu për katër vite si shkollë duke u regjistruar kështu e para shkollë shqipe në fshatin Qerret e njohur nga Ministria e Arsimit e asaj kohe. Në këtë shkollë njëkohësisht edhe mejtep kanë dhënë mësim; Imam Qazim Nushi, Nik Draga, Idriz Qanga etj.”



zonën tonë nuk ka pas. Minarja e xhamisë Qerret ka qenë shumë e bukur. Ka pas do gur të kuq të gdhendur shumë bukur; gdhendur tamam në formën e harkut të rumbullakët siç e do një minare.” E njëjta gjë thuhet edhe nga Elez Dunga (vëlla me Ahmet Dungen) i cili thotë: “Mejtepin e kena pas ba në katin e dytë të xhamisë”. Ndërsa Ahmet Dunga shton: “Mësimet islame na bante imam Qazim Nushi. Mbi 4 vjet, unë kam marr mësim prej tij. Në kohën time mësimin e banim pasdite pasi Myftinia Pukë lejoi përdorimin e Mejtepit si shkollë në shërbim të shtetit. Pra mejtepi jonë shërbeu edhe për shkollë shqipe. Ashtu vazhdoi për rreth 4 vite. Meqenëse paradite Mejtepi u përdor për shkolle imami vendosi dy orare paradite për shkollë pasdite për mejtep.”

Datën e saktë se kur është hapur mejtepi i xhamisë së Qerretit Pukë nuk është e përcaktuar, por sipas të moshuarve të këtij fshati thonë se kanë marr mësim në Mejtepin e xhamisë së Qerretit që në vitin 1892. Njëri nga nxënësit e Mejtepit thotë: “Mejtepi i xhamisë së fshatit Qerret ka qenë i hapur që në vitin 1892”³ Ndërsa sipas të dhënave të tjera del që është i shekullit të 18-të.

Xhamia e fshatit Qerret Pukë ishte

3. Ahmet Dunga; i cili thotë: “Që i vogël babai ime Syl Dani ka shku në xhami si dhe në mësimet e Mejtepit të Xhamisë Qerret dhe babai im është i datëlindjes së vitit 1892. Pra e ka gjet të ngritur Mejtepin e xhamisë së Qerretit.”

dy katesh. Në zonën e Pukës mësohet se vetëm Xhamia e fshatit Qerret dhe Kodër Hani kanë pas minare⁴. Në fillimet e veta mejtepi i xhamisë Qerret ka filluar në katin e dytë të xhamisë së fshatit Qerret. Tek vendi që populli i thotë “Hajat”⁵ qëndronte mësuesi (hoxha) dhe nga aty zhvillonte mësimet islame nxënësve.

Sipas të dhënave në Mejtepin e fshatit Qerret merrnin mësim shumë fëmijë të fshatit dhe se ishte Mejtepi që kishte më shumë nxënës⁶.

Hoxha, ose thënë ndryshe imami më i njohur i këtij fshati ka qenë imam Qazim Nushi, i cili ka shërbyer si imam për rreth 33 vjet. Me mall dhe nostalgji nxënësi i tij Elez Tafllaku thotë: “Hoxhë Qazimi ishte njeri i mirë. Ka shërbyer shpi në shpi në të gjithë fshatin. Ai ishte shumë i varfër. Dha kontribute të mëdha për xhaminë dhe mejtepin e fshatit tonë. I qëndronte pranë çdo kujt dhe ishte i rreptë kur bëhej fjalë për parimet islame. Në mejtepin tonë kanë marr mësimet islame edhe vajzat. Mbaj mend se pothuajse të gjitha gratë e fshatit kanë qenë me shami”⁷.

Ndërsa Ahmet Dunga tregon: “E kena pas aq për zemër imam Qazim Nushin sa që nuk i thonim Qazim Nushi por Hoxha i Qerretit. Axha im Asllan

4. Pa përfshirë këtu xhamitë e Malit të Zi (Dukagjin).
5. Hajat, vendin ku qëndronte myezini.
6. Elez Tafllaku, viti 2012.
7. Elez Tafllaku, viti 2012.

Dani i ka pas marr flokt (në shenjë familjaritetit të tre fëmijeve)”⁸.

Imam Qazim Nushi ka qenë koleg me mësuesit e tjerë si: Nik Draga⁹ dhe Idriz Qanga¹⁰. Nxënësi i Mejtepit Xhemal Ahmet Tafllaku¹¹ thotë: “Edhe mësues Idriz Qanga ka dhënë mësim në Mejtepin e xhamisë Qerret krahas mësimet të shtetit, pasi ai kishte muhabet me hoxhën e Qerretit.”

Nxënësit që kanë marr mësimet islame nga imam Qazim Nushi kanë arritur të bëhen imamë, dhe myezinë. Nostalgjia për hoxhën bën që nxënësit që jetojnë aktualisht arrin ti thonë përmendësh duatë dhe suret. Njëri fillon nga “Rabbi jesir (dhe vijon), tjetri fillon “Amentubilahin (dhe vijon) ndërsa tjetri fillon “Elif , Be , Te, The.. (dhe vijon deri ne fund), si dhe dhjetë suret e fundit të Kur’anit¹².

Jo vetëm nxënësit e imam Qazim Nushit, por i gjithë fshati Qerret edhe sot respekton vlerat kulturore dhe islame që kanë marr nga Mejtepi i Xhamisë së fshatit Qerret.

Sipas të dhënave nga Mejtepi i Xhamisë Qerret kanë dalë figura si: Bajram Cena, i cili ka shërbyer në xhamin e Qerretit, por edhe në xhamin e fshatit Mllojë¹³. Figura të tjera që kanë dalë nga ky mejtep janë edhe: Syl Dani¹⁴, Ram Neziri¹⁵, Murat Musa¹⁶etj.

Mejtepi i xhamisë Qerret u mbyll me ardhjen e komunizmit në Shqipëri.

(Shënim: Ky material u përgatit në kuadër të seminarit “Vlerat Kulturore nën Ndriçimin e Dijes Islame” I zhvilluar më datë; 23 maj 2015 në qytetin e Pukës)

8. Syl Dani është vëlla me Asllan Danin dhe kanë qenë nxënës në mejtep. Në atë kohë mësohet që hoxhë ka qenë një imam nga Shkodra.
9. Nik Draga, Mësues nga Shkodra emëruar mësues në shkollën e re të fshatit Qerret. Për të dhënë kontribut në arsimimin e qytetarëve Myftinia Pukë lejoi që mejtepi i xhamisë Qerret të bëhet shkollë. Dhe ashtu vijoi për disa vite.
10. Idriz Qanga, Po ashtu mësues në shkollën e fshatit Qerret.
11. Xhemal Tafllaku; Nxënës i Mejtepit të xhamisë së fshatit Qerret.
12. Sinkronë me njeri tjetrin edhe sot ish nxënësit e imam Qazim Nushi si: Elez Tafllaku (viti 2012), Elez Dunga dhe Ahmet Dunga përmendin me nostalgji suret dhe duatë e mësuar.
13. Shpjegim i autorit; Gëzim Kopani: “Në atë kohë edhe fshati Mllojë mbulohej fetarisht nga Myftinia Pukë. Sipas Ahmet Dungës kemi se: “Bajram Cena përveç xhamisë së Qerretit ka shërbyer si imam edhe në xhamin e fshatit Mllojë”.
14. Syl Dani, Myezin i xhamisë Qerret Pukë.
15. Ram Neziri, Myezin i xhamisë Qerret Pukë.
16. Murat Musa, imam në xhamin e fshatit Lajthizë-Pukë.

GJENOCIDI NDAJ MUSLIMANËVE NË MIJANMAR (BURMA)

Zyra për Aktivitete Humanitare e Komisionit Evropian (ECHO) ka hartuar një njoftim për gjendjen e muslimanëve në Mijanmar (Burma), ku jetojnë rreth 2.27 milionë muslimanë, të quajtur Rohingya, në krahinën e Arakanit. Në raport theksohet dhuna e organizuar dhe sistematike e popullsisë budiste, në bashkëpunim me regjimin aktual. Sipas të dhënave të tjera,, muslimanët përbëjnë rreth 6-10 % të numrit të përgjithshëm të banorëve dhe janë muslimanë sunitë. (<http://en.wikipedia.org/wiki/Burma>)

Kjo dhunë nuk është e sodit, por ndodh në vazhdimësi, për të kulmuar në disa faza historike, si fjala vjen, gjatë 20 viteve të fundit, rreth 3000 fshatra janë pastruar etnikisht dhe rreth 200 mijë muslimanë janë dëbuar në Bangladeshë.

Këtë dhunë ata as nuk e fshehin, sepse del nga goja e kryetarit së shtetit në takim me përfaqësuesin e lartë të Kombeve të Bashkuara, Antonie Guterresom. Kryetari ka propozuar që të gjithë muslimanët të grumbullohen në kampet e UNHCR-së, për t’i bartur jashtë vendit të tyre. Ata trajtohen si të huaj në tokën e tyre, kurse bota mbyll sytë para kësaj shfarosjeje evidente.

Gazetarët perëndimorë, si Francis Wade, muslimanët e Burmës nuk i sheh të huaj, por mendon se ata ndahen në të hershëm, duke thënë nder në shekullin 17 një qytet në Arakan ka qenë qendër tregtare me të cilin administronte një sulltan musliman. Kemi edhe muslimanë të mëvonshëm, të viteve 1824-1848, në kohën e kolonializmit anglez, por të tillë ka edhe kinezë, të cilët nuk kanë kurrfarë problemi.

Muslimanët nuk kanë të drejtë të lëvizin të lirë në shtetin e tyre. Ata punojnë në punët më të rënda shtetërore pa kompensim, kurse lëvizjet nga fshati në fshat i bëjnë me leje të veçanta

të dhëna nga organet shtetërore. Muslimanët nuk kanë të drejtë në pronë as në punësim. Ata që prej më herët posedojnë pronë, ajo u merret dhe u dorëzohet të shpërngulurve budistë, pikërisht siç bënte Serbia me tokat e shqiptarëve deri në fund të shekullit XX. Raporti i KB për vitin 2007 e përshkruan hollësisht dhunën ndaj Rohingya muslimanëve.

Një gazetar për The New York Times shkruan: “Kjo nuk është një dhunë sektare, ky është pastrim etnik i sponsorizuar shtetëror, kurse vendet e botës nuk bëjnë presion mbi qeverinë e Mijanmarit që kjo dhunë të ndalet.”

Më e tmerrshme është ngatërimi i murgjve budistë në këtë dhunë, duke harruar se veten e paraqesin në botë si pacifistë dhe klerikë të paqes. As Dalaj Lama deri sot nuk e ngriti zërin për t’i thënë STOP dhunës. Aktivistët humanitarë perëndimorë janë të shqetësuar me aktivitetin kriminalë të klerikëve budistë.

Për fat të keq, Rohingya muslimanët nuk gëzojnë përkrahje as nga vetë muslimanët e botës. Bangladeshi refuzon t’i pranojë si refugjatë, kurse protestat e muslimanëve në vendet fqinje janë anemike, pa plan dhe të pafuqishme ta sensibilizojnë botën demokratike. Zëri i shefit të Organizatës së Konferencës Islame drejtuar Suu Kyi që të ndalë dhunën ndaj muslimanëve (“Meqë jeni fitues i Çmimit Nobel për paqe, besojmë se hapat e tuaj të parë drejt krijimit të paqes në botë do të duhej filluar në pragun tuaj”) është i shurdhër për shumëkënd.

Madje, edhe mediat shqiptare janë totalisht të paimparesuara të njoftojnë qytetarët e vetë për këtë katastrofë, duke harruar përvojën e hidhur me Kosovën.



(www.zeriislam.com)

“BETOHUNI SE DO TË QËNDRONI PËR MBROJTJEN E ATDHEUT DERI NË VDEKJE!”

GJURMËT E KRENARISË DHE QËNDRESËS TIPIKE TË BURRAVE TË BESËS, I GJETA TE PERSONALITETI LEGJENDAR I HEROIT TË MADH TË SHKODRËS, KOMANDANTIT TË PAHARRUAR, HASAN RIZA PASHA

Ditëve të fundit, iu përkushtova leximeve mbi rrethimin e Shkodrës nga serbo-malazezët, në prag të pavarësisht dhe pas tij.

Bashkëbisedova në heshtje me disa personazhe dhe ndjeva dhembje, por edhe shumë krenari! Fillimisht, ishte zonja Hortense von Zambaur, ajo që u kthye në burim emocional për leximin e ngjarjeve të atyre muajve të vështirë për Shkodrën dhe banorët e saj. Por, jo vetëm ajo.

Gjurmët e krenarisë dhe qëndresës tipike të burrave të besës, i gjeta te personaliteti legjendar i Heroit të Madh të Shkodrës, komandantit të paharruar, Hasan Riza Pasha. Ndërkohë, nuk mund të kaloja indiferent para shënimeve me vlerë nga At Gjergj Fishta dhe Dom Lazër Shatoja, për të lexuar nëpërmjet vargjeve të tyre, por edhe dëshmime të ndryshme, madhështinë e Hasan Riza Pashës, por jo vetëm...

“Rrethimi i Shkodrës (10 tetor 1912-22 prill 1913)”, është ditari i gruas së konsullit austriak në Shkodër, që është përkthyer në shqip nga i nderuari, Ferit Hafizi. (Pavarësisht faktit se ky ditar është përkthyer nga gjermanishtja në shqip dhe është botuar në vitin 2006, akoma sot, lexohet sikur të sapo kishte dalë nga shtypi.)

Këto rreshta mund t'i kisha shkruar edhe para disa ditësh, kur kisha edhe shkase të tjera përtej leximeve në prag të rënies së Komandantit, por, nuk desha ta përziej madhështinë e emrit dhe veprës së tij me asgjë tjetër, që gjithësesi, do ta shpërqendronte vëmendjen nga lufta



HASAN RIZA PASHA

e paepur dhe qëndresa burrërore e shkodranëve kundër agresionit serbo-malazez në një kohë dobësie dhe, thuaj, gati-gati në pabesi...

I qëndrova besnik zonjës së konsullit austriak, e cila, në ditarin e saj, në shënimet e datës 31 janar 1913, duke iu referuar ngjarjes së një nate më parë, shkruan: “Një natë tragjike! Hasan Rizaja, komandanti i fortesës dhe vali i Shkodrës, është vlarë... Rrugës duke u kthyer në shtëpi, pasi doli nga Esat Pasha, ra në një pritë prej tre vetash që e qëlluan nga prapa... Hasan Rizaja u shemb përtokë, aty ku ishte në rrugë dhe sot në mëngjes, në orën 2, vdiq. Në orën 10 u varros...” – (Ditari i cit., f. 53-54).

Ndërkohë, Hamdi Bushati, duke iu referuar revistës “Çirka”, 1928, teksa përshkruan Komandantin, citon: “Hasan

Riza Pasha me shkencën e vet strategjike ka lënë gjurmë të pashlyeshme në historinë ushtarake si mbrojtës i Shkodrës në rrethimin historik të saj që, ndonëse i huej, tue krye në kuptimin ma të plotë detyrën e tij, kjo një ndër shkaqet jo ma të mramet që Shkodra muejt me qenë pjesë e pandame e nanës Shqipni. Me vullnetin e pathyeshëm të Hasan Riza Pashës u ndalue turri i ushtrive të besëlidhuna balkanike...” – (Hamdi Bushati, “Shkodra dhe motet”, bot. i 2-të, Shkodër, 2005, v. 1, f. 365).

Natyrshëm, nga pozita e një lexuesi të rregullt të historisë, shënimet e kohës së rrethimit të Shkodrës nga serbo-malazezët, na dëshmojnë momente dhe tablo të mbushura me bombardime, predha, vrasje, uri, skamje, tymnaja e frikë në mesin e popullatës.

Dëshmohen edhe fragmente, që mendoj se duhen kujtuar herë pas here, në leximet e historisë së vendit tonë dhe përkujtimin e tyre.

Kam dëshirë të ndaj me ju disa nga këto dëshmi:

“27 tetor 1912. Fshatarët nga zonat e periferisë vërshojnë në qytet. Malazezët, gjatë marshimit të tyre, u vënë zjarrin fshatrave...”

18 tetor 1912. Mijëra shkodranë myslimanë kanë rrokur armët dhe janë betuar që të vdesin për Atdheun...

19 tetor 1912. Në ndërtesën e Bashkisë u ngrit flamuri i gjelbër i Profetit. Lajmëtarë publik (tellalli) bënë thirrje që të luftojnë e të vdesin për Atdheun. Myslimanët janë të mbushur me entuziazëm dhe të shumtë janë ata që

“Hasan Riza Pasha me shkencën e vet strategjike ka lënë gjurmë të pashlyeshme në historinë ushtarake si mbrojtës i Shkodrës në rrethimin historik të saj që, ndonëse i huej, tue krye në kuptimin ma të plotë detyrën e tij, kjo një ndër shkaqet jo ma të mramet që Shkodra muejt me qenë pjesë e pandame e nanës Shqipni. Me vullnetin e pathyeshëm të Hasan Riza Pashës u ndalue turri i ushtrive të besëlidhuna balkanike...”

vrapojnë me armë në duar nëpër trashë.

25 nëntor 1912. Një shpallje e vendosur në mur, e nënshkruar nga Hasan Rizaja dhe Esat Pasha, njofton banorët e Shkodrës se ai që shprehet për dorëzimin e qytetit, do të varet!

28 nëntor 1912. (Dita e pavarësisht. -M.S.). Turqit e tregojnë veten edhe një herë si mbrojtës shumë të fortë.

30 nëntor 1912. Sot, gati sa nuk vdiq! Bombardimi filloi përsëri në orën 2 e gjysmë dhe ka zgjatur deri në orën 6 pa një çerek.

4 dhjetor 1912. Tregojnë se në trashë ka rënë një gjyle me peshë 100 kilogram dhe me diametër 24 centimetër. Kjo bën punë, jo shaka! Po sikur të bjerë në qytet një gjyle e tillë? O Zot, ç'do të bëhet me ne?

3 janar 1913. Bie shi; koha është e zymtë, ashtu si gjendja e jonë shpirtërore...

6 janar 1913. Sonte, në mbrëmje, e ndezëm përsëri pemën e krishtlindjeve. Hasan Rizaja, nëpërmjet kolonel Fahri Beut, i ka dërguar burrit tim një fotografi. Heroi i rrethimit të Shkodrës është i veshur me uniformë ushtarake, me një qëndrim si Napoleoni. Sido që të përfundojë kjo luftë, emri i tij do të shënohet përjetë në analet e historisë!” – (Ditari i cit., f. 18-44).

Dhe, shënimet e zonjës austriake vazhdojnë e vazhdojnë, duke dëshmuar shumë dhembje, frikë e tmerr, si një përjetim real i një lufte “barbare”, (sikurse e cilëson ajo në një vend në ditarin e saj), kundër një qyteti dhe një populli, që asnjëherë nuk ia kthen shpinën as e lanë në baltë!

Lexova, në kontekstet e këtyre

shënimeve modeste, edhe vargjet e Fishtës, pas propozimit të bërë nga Hasan Riza Pasha, për “një marsh shqip për me ua mësue ushtarëve shqiptarë që ta këndonin tue shkue në stërvitje. At Gjergj Fishta ia përgatiti marshin dhe ia dërgoi. Pasha ia shpërbleu njëqind fish tue ia pague strofë e lirë ari turke” – (Hamdi Bushati, v. 1, f. 369).

Ja disa nga fjalët e marshit të gjatë:

“Prej kah lenë e merr hana Mu çue shekulli kundra nesh Djelm kreshnikë na bani nana vetëm na iu dalim ndesh ... Kush të jetë djal në ushtri të Sulltanit Kush të jetë djal që deken ban Të dalin sot ai në fushë të mejdanit Me dhanë jetën për vatan.” – (Hamdi Bushati, v. 1, f. 369).

Dhe, si kurorë, mbi imazhin e kujtimit të paharruar të trimit të madh të kohëve të mbrame, Hasan Riza Pasha, më vijnë ndër mend disa vargje të Dom Lazër Shantojës, që në vitin e largët 1915, do të shkruante:

“Ktu mi ket fang, ku veç do lule të zbeta Badrash kan çilë me gjeth të prehtë si shpata, Ku drita ma së mretnon, së mretnon ma jeta Por deka e nata


Me zemër të vrazhdë prej dhimet krejt shporue Ktu para vorrit t'and në giuj tuj ra Të mramin të përshëndetun sot po due me të çue Të falem, Riza! ... Hasan, Hasan, ku je? Qi ma mi kodra Në kto vende shejte më gjak fatosash, la S'po të shof? Ty sot tuj te thirrun asht marë Shkodra, Ku je Riza?...” – (Dom Lazër Shatoja, VEPR, Shkodër, 2005, f. 38).

E, për fund, fjalët e fundit të Heroit të Madh të Shkodrës, (thujtë i harruar në ditët e sotme, ai dhe ushtarët e tij, shehidët e nderit, që dhanë jetën për mbrojtjen e Shkodrës nga rrethimi serbo-malazez), i cili, në shtratin e vdekjes tha edhe këto fjalë: “Ju la amanet djaln tem, por mos i thoni se më kanë vra, por ra duke luftue! Betohuni se do të qëndroni për mbrojtjen e atdheut deri në vdekje!”..., dhe: “Kerametin! Ma këndo mue një Jasinë Sherifë!” – (Hamdi Bushati, v. 1, f. 373).

Rahmet pastë, i nalti Hasan Riza Pasha! Rahmet paçin shehidët e naltë shkodranë, që ranë duke mbrojtur ATDHEUN e tyre të shtrenjtë, Shkodrën tonë! Mirënjohje dhe përlujtje, brez pas brezi!

Imam Muhamed B. Sytari

Myfti i Zonës Shkodër
Shkodër, më 31 janar 2017



ALL-LLAHU I MADHËRUAR
THOTË NË KUR'AN:

“Dhe, mos thoni
për ata që writen

në rrugën

e All-llahut:

“Janë të vdekur”!


Madje,

ata janë të gjallë,

por ju

nuk e ndjeni”

(KUR'ANI, EL-BEKRAE: 154)

Smajl Bala, *studiuës*

BIBLIOTEKAT FETARE MUSLIMANE NË SHKODËR

së tij, Mehmet Pashë Plakut për vizitë, ai sëpari e shoqëronte në dhomën e bibliotekës. Aty i tregonte mikut se ishte duke parë gjysmën e librave, pasi pjesën tjetër e kishte në pallatin e tij, në Bushat. Përmes vakëfnames të Mustafa Pashës, të vitit 1833 mësojmë se, në ndërtesën me shumë dhoma të Medresesë së Pazarit, biblioteka ishte e vendosur në një godinë të veçantë me dy kate, ku kishte salla studimi, dhoma e rafte për sistemimin e tyre.

BIBLIOTEKA E VAKËFIT

Kjo bibliotekë origjinën e vet e ka shumë të hershme. Se kur është krijuar nuk dihet, por fillesat i ka me ardhjen e Perandorisë Osmane. Ajo filloi të shtojë fondet e librave nga persona të ndryshëm, si hoxhallarë, mësues e myderrizë që merreshin me edukimin shpirtëror të besimtarëve, me besimin islam, të cilët filluan t'i dhuronin vakëf bibliotekës. Gjatë viteve u shtua më tepër me fonde të reja. Po ashtu kur ndonjë hoxhë, apo mësues besimi ndërronte jetë dhe nuk kishin trashëgimtarë, e linte amanet që biblioteka e tij, t'i dhurohet Myftinisë.

Shumica e librave të kësaj biblioteke u trashëguan nga Medreseja e Vjetër e Qafës dhe ajo e Pazarit të Vjetër, dhurimi i bibliotekës së Pashallarëve Bushatlinj të Shkodrës, të Mehmet Pashë Plakut të Karamahmud Pashës e të Mustafa Pashës, bazuar në vakëfnamën e tij të vitit 1833. Shumica e librave në këtë bibliotekë mbajnë vulën e tyre, e cila në fillim ndodhej në Medresenë e Qafës dhe të Medresesë së Pazarit të Vjetër. Më pas kaluan në zyrën e Myftinisë Shkodër. Biblioteka pasurohej dhe shfrytëzohej vazhdimisht, si nga Myftinia e Shkodrës, ashtu edhe nga myderrizët, mësuesit dhe nga populli.

Librat kanë qënë në 2-3 kopje dhe si bibliotekë popullore, ato nga përdorimi u vjetruan shumë. Më së shumti ato kanë qënë në gjuhën klasike orientale, arabe, turke e perse, si dhe në gjuhën shqipe. Aty gjindeshin libra shumë të rrallë fetarë, të fushave të tjera të dijes njerëzore, por dhe të kolosëve të letërsisë së orientit. Për administrimin e tyre kanë punuar intelektualë të njohur, poliglotë të shquar e hoxhallarë, që njihnin me rrënjë e themel këto gjuhë, si Hamdi Bushati, Hafiz Muhamet Kuçiqi, Hafiz Abdullah Berdica (Neziri) dhe së fundi Hafiz Esat Myftia, i cili punoi edhe mbas vitit 1967 kur të gjitha bibliotekat e institucioneve

fetare dhe të hoxhallarëve që patën në shtëpitë e tyre i kaluan bibliotekës së qytetit Shkodër. Në vitin 1990, ky fond, natyrisht i reduktuar në vite e pas dëmtimeve, u soll nga Myftinia e Shkodrës dhe kaloi në fondin e bibliotekës së Medresesë “Haxhi Sheh Shamia”, ku dhe përsëri lëvizti prej aty në një vend tjetër.

Biblioteka në Pazar të Vjetër ka qënë pranë Medresesë së Pazarit të Vjetër në një godinë në vehte prej dy katesh, me disa dhoma e salla studimi. Me mbylljen e Medreseve, biblioteka kaloi në zyrën e Myftinisë, por thonë se një pjesë e saj kaloi në duart e mësuesve e myderrizve që patën dhënë mësim.

Në arkivin e hershëm të vakëfit ka qënë një vakëfname (*dokument që tregon se është lanë vakëf*) e cila tregon se biblioteka ishte shumë e moçme (hershme).

Kjo bibliotekë ka shërbyer edhe të tjerëve dhe kushdo mund të merrte me firmë dhe t'i kthente mbas leximit përsëri.

BIBLIOTEKA KËLLIÇI (MYFTIEJ) NË LAGJEN QAFE (TABAKE)

Biblioteka ka qënë një ndër më të vjetrat dhe më të hershmet në Shkodër, e krijuar nga Hafiz Hasan Këlliçi, në vitin 1230 hixhri, i cili ishte kadi zyrtar i Shkodrës dhe kish tërhequr simpatinë e gjithë banorëve të Shkodrës pa përjashtim. Ishte njeri studioz e inteligjent. Ky nëpunës i gjendjes civile, gjyqtar, e kadi (siç i thoshin në atë kohë), për funksionin që mbante ju desh një përgatitje e mirë. Për këtë qëllim, si njeri i ditur formoi këtë bibliotekë. Me këtë kadi filloi hapat e parë të saj, si një bibliotekë më të vërtetë serioze.

Pas vdekjes së Hafiz Hasan Këlliçit, nipi i tij Jusuf Efendi Tabaku, i cili edhe ky si gjyshi i tij veproi për të mirën e popullit të Shkodrës dhe kish tërhequr simpatinë e banorëve të qytetit dhe të rretheve. Jusuf Tabaku e trashëgoi këtë bibliotekë dhe luajti një rol të rëndësishëm në pasurimin e kësaj biblioteke.

Shtëpia ku ndodhej biblioteka ka qënë nën kala “Rozafa” në lagjen Qafë (Tabakë) dhe pranë lumit Drin.

Biblioteka në vite pësoi dëmtime. Në shënime të qënë Jusuf Efendia, mësojmë se: “një rrufe që ra në depot e municioneve të kalasë djegu dhe shtepinë e këtij dijetari të lartë musliman të Shkodrës”, që pastaj u bë Myfti i Shkodrës, deri në vitin 1904 që vdiq. Ai la përshkrimin se: “Me 8 të muajt

Qanuni Evele, ditën e diel në orën 3 allaturka të vitit 1290 xhybehaneja që u gjend në kala të Shkodrës mori flakë, nga një rrufe e mndershme me të ndezun të municionit u bë zhari krejtësisht dhe shtëpia e jonë mbrenda së cilës mbaroi gjithçka. Unë dhe djali i jem pështuam, 5 veta të tjerë sharruen zhar në atë zjerm. Gëzoshin paqen e Zotit. Bashkë me teshat e shtëpisë, e shumta e librave më mbaruen. I madhi Zot ma shpërblejt në kohën që shpërblehen tana punët.”

Nga ky përshkrim i tij kuptohet se Jusuf Tabakut nuk i shpëtoi gjë pa u djegur, po edhe në rast se i shpëtoi gjë këto i mori lumi Drin dhe ajo që shpëtoi u mblodh prej tij dhe u ruajt në bibliotekë, me afro 2000 volume në gjuhën arabe, turke, persiane e pak frëngjisht.

Më pas, trashiguesi i kësaj biblioteke qe Hafiz Esat Myftinia, i cili e sistemoi në bazë të inventarit të vjetër të lënë nga Jusuf Efendia. Ato i ndau dhe i sistemoi në 30 grupe, ose lëndë të ndryshme gjithë librat e bibliotekës së tij, si filozofi, teologji, theosofi, letërsi, gramatelloji, gjuhë shqipe dhe pak frëngjisht, lëndë të lidhura ngushtë me fenë islame.

Nga inventari që ka lënë Jusuf Efendia, biblioteka përmbante këto libra, në këto lëndë: 1. Tefsire=Interpretime të Kur'anit. 2. Texhvit=si shqiptohet Kur'anit, tematika e Kur'anit. 3. Kiraet=si shqiptohet Kur'anit, fonetika e Kur'anit. 4. Hadis=Fjalë profetike. 5. Meuiza=Predikime. 6. A-Kaid=Teologji. 7. Hiqmet=filozofi. 8. Fikh=Udhëzime feje. 9. Fetava=Gjykime. 10. Usuli Fikh=Baza e fikhut. 11. Feraiz=Përpjesëtim pasurie mbas vdekjes. 12. Tessavuf=Mysticism. 13. Meanij=Letaratyr. 14. Bejan=Retorik. 15. Nahv=Sintaks. 16. Urus=Rima, rrjedh vjersha, zburkimi i fjalës. 17. Sarf=Etemologji e fjalëve arabe. 18. Lugat=Fjalor të ndryshëm. 19. Mantike=Logjikë. 20. Adab=Advukatur. 21. Tarih=Histori. 22. Qimia=Kimi. 23. Hisan-Mendese=Matematike (numerator), gjeometri, trigonometri. 24. Xhografia=Gjeografi. 25. Mytemviat=të ndryshme. 26. Mexhmua=Përmbledhje. 27. Astolab=Astronomi. 28. Shqip. 29. Frëngjisht.

Veç librave biblioteka ka pas edhe shumë dorëshkrime të moçme, njëri prej të cilëve kishte një rendësi të veçantë (të posaçme) VEHBIIJE, shkruar nga Tahir Efendi Gjakova i njohur me emrin Tahir Efendia i Madh. Kjo bibliotekë mbas librave me shume vlerë, mbante edhe dy tahte astronomike të Hoxha Tahsinit, të botuara në Paris në vitin 1284 h.

Një pjesë të librave është e kuptueshme se kanë qënë edhe të Jusuf Efendisë, i cili

**THUHET SE NË SHKODËR
KA PAS MBI 25.000 VOLUME,
VETËM NË GJUHËN KLASIKE
ORIENTALE DHE MBI
10.000 VOLUME
NGA BIBLIOTEKAT
PRIVATE FAMILJARE.**

mbasi i dorëshkruante ato i lidhte vetë me karton, kështu që formonte volume me radhë. Në këtë bibliotekë ka qënë dhe një nga dorëshkrimet e tij mbrenda të cilit përmbante shumë ngjarje me rendësi historike, si psh. datat e qeverisjes të pashallarëve, me emrat e tyre. Herë herë tregon edhe ndonjë ngjarje me karakter historik si dhe vetjak, etj.

Simpatia e mbarë popullit të Shkodrës që pat për Jusuf Tabakun e tregoi me rastin e rrënimit (djegies) së shtëpisë, ku menjëherë pas ngjarjes i shkon në ndihme dhe më plot respekt i ofruan këtij të fundit, një shtëpi të pajisur me gjithçka, ku të donte, ndër lagjet e tyre.

Më vonë sic ka thënë Hafiz Esat Myftia, në lidhje me krijimin e kësaj biblioteke se: “Biblioteka, themelet e para të saj i vuri me të përmendurin Hasan Efendi Këlliçi.” Për datë skemi dokumenta, vetem dimë mbas të nipit, të tretit brez simbas një dorëshkrimi që dokumenton tu e datë rrënimin e parë të shtëpisë si edhe të bibliotekës. Ka datën 1290, të vjetit rumi, që me këtë të sotmen korrespondon ... shtyje dy breza më tej dhe kuptojmë datën jo te sigurtë të themelimit të saj.

Me vonë biblioteka ka pësuar përsëri dëmtime nga një djegie tjetër.

Dëmtimin më të rëndë dhe krejtësisht e pat nga shteti, në vitin 1967 që u morr prej tij dhe shumica e librave kaluan në bibliotekën e qytetit të Shkodrës, së bashku me bibliotekat e tjera fetare të hoxhallarëve, të cilat u sistemuan në këtë bibliotekë nga Hafiz Esat Myftia i emëruar enkas për këtë qëllim.

Megjithatë sipas thënies së Mithat Myftisë, administrues i mëvonshëm mësojmë se, “një pjesë shumë e vogël e librave u fshehën nga ne në vende të padukshme të shtëpisë. Por për fat të keq edhe këto u dogjën me djegien e shtëpisë pas demokracisë.”

BIBLIOTEKA MYFTIEJ NË LAGJEN NDOCEJ

Si biblioteka e Myftiej në lagjen Qafë edhe kjo radhitet ndër më të hershmet, të vjetrat dhe më të pasurat e rrethit Shkodër. U krijua 300 vjet më parë, nga Salih Efendia i Madh dhe u trashigua e u pasurua brez pas brezi, mbasi kjo familje pati trashigimi hoxhallarësh dhe myftilerësh, të cilët u interesuan direkt për ruajtjen dhe pasurimin e saj, me fonde të reja librash. Ndër më kryesoret sic thamë më lart në këtë rrafsh qe Salih Efendia i Madh dhe pastaj pasardhësit e tij. Sic thuhet që herët pjesën më të madhe të librave Salih Efendia i solli nga Stambolli me kal, të cilit ia dha vet Mustafa Pasha kur e pranoi propozimin e tij për tu emëruar myderriz në Medresën e Qafës, i cili qe myderrizi i parë Shqiptar së bashku me Myrteza Shoshin, që dhanë mësim në këtë Medrese. Ajo afërsisht numëronte mbi 2000 volume librash fetarë si filozofi, juridicencë fetare, shkencore, letrare dhe artistike, të shkruara të gjitha në gjuhën orientale dhe më vonë shqip.

Edhe kjo, si bibliotekat e tjera u mor nga shteti, në vitin 1967 dhe një pjesë e saj u sistemua në bibliotekën e qytetit të Shkodrës.

Është për t'u përmendur edhe biblioteka e Medresesë të viteve 1944-1947, në lagjen Zdralej, ku më parë qe Mejtepi i Molla Medos, e cila u krijua nga biblioteka e Vakëfit, por edhe nga ato të dhuruara nga familjarët e disa hoxhallarëve, siç qënë psh. të familjes Hafiz Jusuf Këlmendit, Sheuqet Ymeraj, etj, fakt të cilën na e vërteton një letër e Myftinisë së Shkodrës, me anë të së cilës falënderohet kontributi i tyre.

Në qytetin e Shkodrës ka pasur me dhjetra e qindra biblioteka familjare, në familjet e hoxhallarëve dhe të intelektualëve të kohës. Të qënurit hoxhë me shkollë të nivelit të medreseve, apo të shkollave të larta teologjike të kryera jashtë shtetit, të intelektualëve me një kulturë të gjerë, të kohës nënkupton dhe qenien e bibliotekave të vogla, por me libra të shumtë. Ato pasuroheshin herë pas here dhe sistemoheshin në rafte, dhoma e studio të veçanta. Fondi i tyre shtoej pa ndërprerje, si në numër të bibliotekave ashtu dhe të librave që mbanin në to. Familjarët e hoxhallarëve tregojnë se, në vitin 1967 janë marrë librat e tyre nga shteti me sharabajka apo karroca.

Thuhet se në Shkodër ka pas mbi 25.000 volume, vetëm në gjuhën klasike orientale dhe mbi 10.000 volume nga bibliotekat private familjare.

Paraditën e së mërkurës, më 1 shkurt 2017, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një vizitë pune, Kryetarin e Shoqatës “Istanbul”, z. Ridvan Seferaj.

Gjatë këtij takimi, Myftiu vlerësoi kontributin e deritanishëm të Shoqatës “Istanbul” në Shkodër, në shërbim të vlerave të Thirrjes Islame, nëpërmjet aktivitetit të gjerë, në mbështetje të arsimit, vlerave bamirëse etj.

Myftiu tha se vit pas viti, kontributet e Shoqatës “Istanbul” kanë dëshmuar për mbështetjen e vazhdueshme të aktivitetit të medresesë, si dhe bashkëpunimeve të frytshme me Myftininë Shkodër, në ruajtje dhe zhvillim të gjurmëve të traditave shekullore islame në vendin tonë.

Myftiu shprehu mirënjohjen, falënderimet dhe mbështetjen e tij për kontributin e madh të kësaj shoqate bamirëse, sidomos për gjurmët e dëshmuara në shërbim të edukimit të fëmijëve në Medesënë “Haxhi Sheh Shamia”, me dy degët e saj.

Nga ana e tij, z. Seferaj, e falënderoi

MYFTIU PRITI KRYETARIN E SHOQATËS “ISTANBUL”



Myftiun për mbështetjen dhe bashkëpunimet e larmishme ndër vite, sikurse theksoi se Shoqata “Istanbul” do të vazhdojë të japë kontributet e saj në rrugën e nisur me shumë mund e sakrificë nga drejtuesit e Vakëfit “Hydaji” në

Stamboll të Turqisë, të cilët vazhdimisht kontribuojnë në drejtim të rritjes së aktivitetit bamirës.

Myftiu dhe Kryetari i “Istanbul” diskutuan për disa çështje që lidhen me bashkëpunimin dypalësh.

PËRKUJTOHET HISTORIA E LAVDISHME E MBROJTJES SË SHKODRËS, 1912-1913



Paraditën e së martës, më 2 shkurt 2017, Myftinia Shkodër organizoi një tryezë shkencore në memorie të luftës heroike për mbrojtjen e Shkodrës nga rrethimi serbo-malazez, 1912-1913 dhe roli i madh i Komandantin legjendar, Hasan Riza Pasha.

Referatin kryesor e mbajti historiani i mirënjohur, prof. dr. Bajram Xhafa, i cili paraqiti para të pranishëmve një tablo të ngjarjeve kryesore gjatë ditëve të rrethimit disa mujor të Shkodrës nga forcat serbo-malazeze, si dhe trimëritë dhe qëndresën burrërore të qytetarëve

shkodranë nën komandën e Hasan Rizasë.

Historiani i nderuar vuri theksin te disa momente kyçe të kësaj periudhe, sikurse theksoi se akoma sot, kjo qëndresë heroike e popullit shqiptar ndaj një agresioni barbar, mbahet në heshtje, madje është transformuar si histori.

Ai solli në vëmendje të pranishëmve kronikat e shkruara të kohës nga të huajt, që dëshmojnë më së miri të vërtetat e qarta të kësaj lufte heroike të shkodranëve të rrethuar në këtë kohë.

Diskutuan edhe H. Fejzi Zaganjori, prof. Ferit Hafizi, i cili ka përkthyer ditarin

e znj. Hortense von Zambaur, gruaia e konsullit austriak në Shkodër gjatë periudhës së rrethimit, si dhe librin e Edith Durhamit mbi rrethimin e Shkodrës.

Aktivitetin e përshëndeti edhe Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, si dhe Kryetari i Shoqatës “Ana e Malit”, z. Ruzhdi Poda.

Gjatë kësaj tryeze shkencore u theksua se duhen shtuar tubime dhe aktivitete të tilla që mbajnë të gjallë kujtimin e të parëve dhe forcojnë ndjenjën kombëtare në mesin e qytetarëve të Shkodrës.

ZVICËR, MYFTIU I SHKODRËS LIGJËROI NË 20 VJETORIN E XHAMISË “MËRGIMI”

Ditën e shtunë, më 4 shkurt 2017, me ftesë nga Bashkësia Islame Shqiptare “Mërgimi”, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, mori pjesë në ceremoninë jubilarë të 20 vjetorit të xhamisë shqiptare në Affoltern am Albis, Zvicër.

nuk i bëhet padrejtësi njeriu!”

All-llahu i Madhëruar ju dhashtë mbarësi dhe suksese, ju dhe familjeve tuaja fisnike, për të jetuar në harmoni të plotë me qytetarët e këtij vendi dhe kësaj toke, për të respektuar dhe për t’u respektuar, si shqiptarë të mirë,



I ftuar special i këtij aktiviteti, Myftiu ligjëroi mbi rolin e xhamisë në ndërtimin e personalitetit të muslimanit dhe ndërtimit të urave të komunikimit dhe harmonisë komunitare. Në ligjëratën e tij, Myftiu theksoi: “Përshëndes me zemër 20 vjetorin e xhamisë “Mërgimi”, këtu në Affoltern am Albis të Zyrihut; një arritje e madhe, një dëshmi besimi, qytetarie e besnikërie e shqiptarëve të mirë të kësaj zone, që keni ruajtur me pastërti e sinqeritet të madh elementët më të rëndësishëm të dinjitetit tuaj njerëzor; besimin e shenjtë, gjuhën e dashur, traditat e vyera kombëtare, harmoninë e shtrenjtë komunitare në këtë vend të dashur, që ju ka hapur krahët e zemrës, duke ju mirëpritur ju dhe familjet tuaja, duke ju krijuar mundësi për punë, jetesë e fitim hallalli.


Në një mënyrë a tjetër, emri i xhamisë tuaj me realitetin e largimit tuaj nga vendlindja e shtrenjtë, më ngajnë me emigrimin e parë të muslimanëve të Mekës, të cilët, Resulull-llahu (a.s) i udhëzoi të shkonin në një vend, për të cilin tha: “Aty është një mbret, tek i cili,

si muslimanë të mirë, si njerëz plot dinjitet dhe fisnikëri!”

Gjatë kësaj vizite, Myftiu zhvilloi takime të ngrohta vëllazërore me personalitete të njohura të Thirrjes Islame në mesin e shqiptarëve të Zvicrës, por edhe më gjerë, sikurse falënderoi imamin e nderuar, Festim ef. Miftari për shërbimet e tij dhe aktivitetin e dobishëm në xhaminë “Mërgimi”.

Ndërkohë, të dielën, më 5 shkurt 2017, Myftiu mbajti një ligjëratë edhe në xhaminë e madhe të shqiptarëve në Zyrih, ku hodhi dritë mbi rëndësinë e të qenit të përgjegjshëm në jetë, sikurse nxiti forcimin e vlerave të vëllazërisë dhe harmonisë në mesin e shqiptarëve që jetojnë në Zvicër dhe dëshminë tyre si njerëz të qytetëruar, të dobishëm për shoqërinë dhe ndërtues.

Ditën e martë, më 7 shkurt 2017, gazeta vendase “Anzeiger”, botoi një kronikë të zgjeruar të ceremonisë jubilarë të 20 vjetorit të xhamisë shqiptare “Mërgimi”, në Affoltern am Albis.



Ebu HUREJRA (R.A) TRANSMETON SE PEJGAMBERI (A.S) KA THËNË:

All-llahu i Madhëruar

do të thotë

në ditën e kiametit:

Ku janë ata që

janë dashur për hatrin Tim?

Sot, do t’i strehoj

nën hijen Time,

në një ditë, kur nuk ka hije,

pos hijes Sime!”

(Imam Ahmedi dhe Muslimi)

Ditën e mërkurë, më 8 shkurt 2017, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një takim pune me një grup imamësh të qytetit dhe fshatit. Në qendër të vëmendjes së këtij takimi ishin provokimet primitive, me të cilat përballen muslimanët e vendit gjatë këtyre ditëve, imamët, mësuesit e Medresesë etj.

Myftiu theksoi se këto kohë janë të rrethuara nga injoranca primitive dhe provokimet e shumta ndaj komunitetit tonë, sidomos nga rrjetet sociale, disa media në veçanti, por edhe institucione që nuk respektojnë veten dhe tejkalojnë kufijtë e logjikës në vitin 2017.

Myftiu tha se detyra e imamëve është të vazhdojnë thirrjen e tyre të pastër, të punojnë pa ndërprerje me rininë dhe të distancohen nga provokimet banale, që janë kthyer në dëshmi të një ekstremizmi të pakontrolluar dhe islamofobik ndaj Islamit dhe muslimanëve në këtë vend! “Nuk do ta ndalim hovin e aktivitetit tonë as për hatrin e ca mediave-kërpudha të provincializmit, që gjithësesi nuk përfaqësojnë Shkodrën dhe shpirtin

MYFTIU TAKOI IMAMËT RRETH SPROVAVE DHE PROVOKIMEVE TË KOHËS



e qytetarisë sonë, edhe pse shpesh fshihen pas emrit të madh të Shkodrës, as për injorancën ekstreme të komenteve dhe kërcënimeve ekstremiste, as për individë që duhet t'u tregohet kufiri në marrëdhëniet tona institucionale!” - tha ndër të tjera Myftiu.

Myftiu tërhoqi vëmendjen edhe për disa çështje të brendshme, që lidhen me dinamikën e Thirrjes Islame në Shkodër

dhe përtej saj. Nga ana e tyre, imamët shprehën indinjatën e tyre edhe për debatet shterpë që lidhen me xhaminë e Sulltan Mehmet Fatihut dhe dhanë mendime të shumta rreth kësaj teme.

Njëkohësisht u caktua edhe data e konferencës së 6-të të përvitshme të imamëve dhe këshillave të Myftinisë Shkodër etj.

INSPEKTOHEN PUNIMET E XHAMISË SË RE NË KRYE-BUSHAT

Ditën e enjte, më 9 shkurt 2017, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari dhe Drejtori i Fondacionit “Mirësia”, z. Korab Kaja, zhvilluan një inspektim në terren për të parë nga afër punimet për xhaminë e re në Krye-Bushat, që dalëngadalë po i afrohen fundit. Xhamia e re është pjesë e bashkëpunimit të

Myftinisë Shkodër me Fondacionin “Mirësia”, në një vakëf të vjetër, ku ka ekzistuar xhamia ndër shekuj.

Tashmë, edhe lagjet muslimane të zonës së Krye-Bushatit do të kenë xhaminë e tyre të re me ambientet e reja për mësimin e fëmijëve dhe ambientet e bollshme për zhvillimin e aktivitetit normal. Myftiu dhe z. Kaja

shprehën mendimet e tyre rreth disa përmirësimeve të nevojshme, në kuadër të përsosjes së punimeve në këtë xhami të re.

Për momentin po punohet për zbukurimet e brendshme të xhamisë, që do t'i japin asaj një pamje shumë tërheqëse për vizitorët dhe frekuentuesit e saj.

XHAMIA E RE, KRYE-BUSHAT



BASHKËSIA ISLAME E ULQINIT ORGANIZON AKTIVITETIN: “MUHAMMEDI (A.S) – SIMBOL I PAQES”

Të shtunën me 18 shkurt, në Qendrën për kulturë në Ulqin u mbajt programi madhështor “Muhammedi (a.s) – Simbol i paqes.”

Në sallën, e cila ishte e vogël për të pranuar të gjithë të interesuarit, u organizua nga Bahskësia Islame një program i begatë ku morën pjesë dy teologë të shquar të trevave shqiptare: Imam Muhamed Sytari, Myfti i Shkodrës dhe prof.dr. Metin Izeti.

Programin e hapi me lexim Kur’ani Egzon Ibrahim i cili poashtu kënaqi publikun me këndim të ilahive dhe pastaj vazhduan fëmijët e Kopshtit të BI me performansën e tyre.

Kryeimami mr. Ali ef. Bardhi përshëndeti tubimin, ku ceku rëndësinë e rolin të prezantimit sa më dinjitoz të vlerave islame duke shtuar se qëllimi i këtij organizimi është pikërisht nevoja për të hedhur dritë mbi rolin e Muhammedit (a.s) për paqe.



Myftiu i Shkodër, Imam Sytari foli për filozofinë e paqes nga këndvështrimi i ajetit kur’anor i cili flet për ‘të bindurit e të Gjithëmëshirshmit’ e që janë ata që në çdo situatë promovojnë paqen, bile edhe kur etiketohen, apo sulmohen nga njerëzit e ulët.

Myftiu poashtu ngjalli emocione të veçanta duke sjellë detaje prekëse të jetës së përditshme të Muhammedit (a.s) në raport me çdo njeri, duke filluar nga moshat më të vogla, e deri te armiqët më të ashpër, ku Muhammedi (a.s) me porositë dhe me sjelljen e tij fitonte zemrat e atyre që e rrethonin, duke i bërë ambasadorë të paqes në viset ku i dërgonte për të përcuar mesazhin islam.

Nga ana tjetër, prof.dr. Metin Izeti beri në qasje fenomenologjike të çështjes në fjalë duke përcjellur fenomenin islam që nga Ebu Xhehli, si arketip dhe paradigmë e së keqes, përballë profetit Muhammed (a.s) si bartës i paqes dhe duke vazhduar kështu me historinë e bujshme islame në periudha të ndryshme, për të arritur në kohën tonë deri në postmodernë, aty ku Islami – në teorinë e Huntingtonit – del në anën e kundërt të paqes, ndërsa ky prezantim i shoqërisë mbarë njerëzore të ndarë në blloqe nuk është në gjendje reale, por projekt i financuar nga qendrat e mëdha, të cilat punojnë për ribërjen e rendit të ri botëror.

Bartja reale e paradigmes profetike me parimet shpirtërore, intelektuale dhe morale në shoqërinë tonë – dhe jo e formës së organizimit shoqëror të shekullit të VII – dhe në jetën e përditshme do të jetë një zgjidhje e shoqërive muslimane drejt një sistemi teocentrik – tha mes tjerash dr.Metin Izeti.

Programin e hijeshoi edhe kori i medresesë “Mehmed Fatih” në Podgoricë me këndimin e ilative të ndryshme.

(www.islam-ul.com)

MYFTINIA SHKODËR NË NDIHMË TË NJERËZVE NË NEVOJË

Paraditën e së martës, më 14 shkurt 2017, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, vizitoi në banesën e saj përdhese një nënë të moshuar, të vetmuar e të braktisur në mjerimin e saj.

Paa kronikës së transmetuar ditën e djeshme nga mediat lokale, Myftinia Shkodër vendosi t'i vijë në ndihmë kësaj nënë të plakur, duke u solidarizuar me rastin e saj.

Në mesazhin e tij para mediave të pranishme, Myftiu, pasi falënderoi mediat lokale të Shkodrës për evidentimin e herëpashershëm të këtyre rasteve, tha se nëna, si simbolikë, është e shtrenjtë, e shenjtë dhe nuk braktiset.

Myftinia Shkodër fton bizneset muslimane, autoritetet lokale dhe krejt bamirësit, që të ndihmojnë me sa të kenë mundësi këtë nënë të vetmuar, që jeton në kushte jashtëzakonisht të vështira.



MEDINE: KRYEQYTETI TURISTIK I BOTËS ISLAME 2017

Në vitin 2015 kryeqyteti turistik i botës islame ishte zgjedhur Jerusalemi kurse në vitin 2016 ishte zgjedhur qyteti Konya në Turqi.

Medine: Kryeqyteti Turistik i Botës Islame 2017

Medine është zgjedhur nga Organizata e Bashkëpunimit Islamik (OBI) si "Kryeqyteti Turistik i Botës Islame 2017".

Në këtë kuadër në Medine, me pjesëmarrjen e presidentit dhe kryetarit të Bordit të Komisionit të Arabisë



Saudite për Turizmin dhe Trashëgiminë Kombëtare, Sultan bin Selman bin Abdulaziz,

Sot në Medine janë prezantuar aktivitetet që do të mbahen gjatë gjithë vitit.

Në vitin 2015 kryeqyteti turistik i botës islame ishte zgjedhur Jerusalemi kurse në vitin 2016 ishte zgjedhur qyteti Konya në Turqi.

(www.trt.net.tr)

KANCELARJA MERKEL: FEJA ISLAME NUK ËSHTË BURIMI I TERRORIZMIT

Kancelarja gjermane Angela Merkel, tha të shtunën se lidhjet e Evropës me Rusinë kanë mbetur sfiduese, por ishte e rëndësishme bashkëpunimi në luftën kundër terrorizmit islamik.

"Lufta e përbashkët kundër terrorizmit islamik është një fushë ku ne kemi interesa të njëjta dhe ne mund të punojmë së bashku", tha Merkel në një fjalim në Konferencën e Sigurisë në Mynih, ku zëvendëspresidenti amerikan Mike Pence ishte në audiencë.

Merkel e cila ka qenë kritike ndaj vendimit amerikan për të ndaluar hyrjen në SHBA të shtatë vendeve me shumicë myslimane, theksoi se vetë Islami nuk ishte burimi i terrorizmit. Ajo tha se ishte kritike për të përfshirë vendet myslimane në luftën kundër terrorizmit islamik.



Gjermania, nën presionin në rritje nga ana e udhëheqësve amerikanë për të rritur shpenzimet e saj ushtarake, do të bëjë "çdo gjë që është e mundur" të përbushur një

objektiv të NATO-s për shpenzimin e 2 për qind të prodhimit ekonomik në mbrojtje nga 2024, tha Merkel në konferencë.

(www.radiojehona.al)

PAGA PËR GJYSHET NË TURQI BËN BUJË BREDA DHE JASHTË VENDIT

Sipas këtij programi që është në fazën e provës, në fillim do të përfitojnë 6 mijë gjyshe në qytetet më të mëdha të Turqisë.

Programi i qeverisë turke për pagën kundrejt gjysheve që kujdesen për nipërit dhe mbesat e tyre bëri një jehonë të madhe jo vetëm brenda Turqisë por edhe jashtë saj.

Sipas këtij programi që është në fazën e provës, në fillim do të përfitojnë 6 mijë gjyshe në qytetet më të mëdha të Turqisë.

Aplikimi për tërheqjen e pagës filloi në datën 9 shkurt 2017 por pati një fluks aq të madh sa që Drejtoria e Sigurimeve Shoqërore u detyrua të ndërpriste aplikimet që arritën në 67 mijë vetëm brenda pak ditësh.

Ndër kriteret që duhet të plotësojë gjyshja janë:

Gjyshja duhet të jetë nënshitetur turke.

Duhet të banojë në një nga qytet ku do të fillojë programi dhe gjithashtu duhet të banojë në të njëjtin qytet me nipin ose mbesën.

Fëmija duhet të jetë më i vogël se 3 vjeç.

Nëna e fëmijës duhet të jetë mbi 18 vjeç dhe e punësuar si dhe duhet të ketë mbaruar periudhën e lejes së paslindjes.

Qeveria turke me anë të këtij programi synon mirëqenien e grave që punojnë por edhe shpërblimin e gjysheve të cilat bëjnë një punë të palodhur për të rritur nipërit e mbesat e tyre të dashura.

(www.trt.net.tr)

STAMBOLLI KA 3.262 XHAMI, VETËM NË LAGJEN FATIH JANË 340

Qyteti turk Stambolli, i cili me 14.8 milionë banorë përbën 18.5 përqind të popullsisë së përgjithshme të Turqisë, njëherit është edhe qyteti me numrin më të madh të xhamive në vend, raporton Anadolu Agency (AA).

Sipas të dhënave të Muftinisë së Stambollit, në këtë qytet ka 3.362 xhami, kurse vetëm në lagjen Fatih janë 340 xhami.

Pas lagjes Fatih radhiten lagjet Yskydar me 186 xhami, Ymraniye me 143 xhami, Beykoz me 136 xhami dhe Pendiku me 133 xhami. Numri më i vogël i xhamive në Stamboll është në Ishujt e Princëve, ku janë vetëm nëntë sosh.

Kështu, në Stambollin me 14.8 milionë banorë, një xhami është për 4.403 persona.

Stambolli që nga pushtimi i saj në vitin 1453 deri në rënien e kalifatit në vitin 1923, ishte kryeqyteti i shtetit Osman, ku në periudhën prej afro 500 vitesh në këtë qytet janë ndërtuar shumë xhami, të cilat shënojnë një epokë të tërë historike.

Në mesin e xhamive më të



rëndësishme, të cilat gjatë gjithë vitit vizitohen nga dhjetëra mijëra turistë nga e gjithë bota, sigurisht që dallojnë Xhamia e Kaltërt, Xhamia Fatih, Xhamia Sulejmanije dhe shumë të tjera.

Gjithashtu rikujtojmë se janë në përfundim e sipër punimet në xhaminë Camlica në Stamboll, xhamisë më të madhe të Turqisë moderne.

(www.radiojehona.al)

SHBA, MBLIDHEN MBI NJË MILION DOLLARË PËR XHAMINË E DJEGUR

Për pesë ditë janë mbledhur më shumë se një milion dollarë për ndërtimin e xhamisë në shtetin federal amerikan Texas, e cila tërësisht u dogj gjatë zjarrit, transmeton Anadolu Agency.

Xhamia, e cila është pjesë e Qendrës Islame në Victoria dhe një nga faltoret e rëndësishme për muslimanët në Texas, u dogj ditën e shtunë, më 2 shkurt 2017.

Në qytetin prej rreth 62.000 personave, gjatë donimit, përveç muslimanëve, janë bashkuar edhe pjesëtarët e besimeve tjera, por edhe ateistët, njofton gazeta "Independent".

Përveç kësaj, muslimanëve u është ofruar që derisa xhamia nuk është gati për lutje, ritet fetare t'i bëjnë në sinagogën e qytetit dhe disa kisha.

Shefi i brigadës së zjarrfikësve të Victoria-s Jeff Cowan theksoi se në lagjen dhe rrethinën në të cilën erdhi deri tek zjarri nuk është gjetur asgjë e dyshimtë, ndërsa është duke zgatur hetimi për atë



nëse bëhet fjalë për krim nga urrejtja. Udhëheqësit e qendrës përmes rrjeteve sociale shpërndanë fotografi të shkatërrimit të xhamisë nën të cilat shkruanin "sërisht do ta ndërtojmë me

dashuri". Ende nuk dihet shkaku i zjarrit në xhaminë në Texas, ndërsa hetimet edhe më tej zgjasin.

(www.radiojehona.al)



Pejgamberi (a.s) ka thënë:

**“RESPEKTOJE NËNËN,
SEPSE XHENNETI
ËSHTË NËN KËMBËT E SAJ!”**

(transmetuar nga Nesaiu, Tabaraniu dhe Hakimi)



Është pyetur nëna: Kë do më shumë prej fëmijëve?!

Dhe ajo është përgjigjur:

TË SËMURIN, DERISA TË SHËROHET, UDHËTARIN, DERISA TË KTHEHET,

TË VOGLIN, DERISA TË RRITET, PASTAJ, TË CJITHË, DERI NË VDEKJE!

**MYFTINIA
SHKODËR**



www.myftinia-shkoder.org

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIA SHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org